REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 335/20
Datë/Datum. 21.07.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr.335/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z.Blerim Dina -Kryetar, z.Nuhi Paçarizi -Referues dhe z.Goran Milenković - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Optimizimi i Kazantores Ndihmëse", me numër të prokurimit: KEKO-20-027-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK), me datën: 08.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit OE "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Optimizimi i Kazantores Ndihmëse", me numër të prokurimit: KEKO-20-027-511, të iniciuar nga AK – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK) .

II.ANULOHET, njoftimi për anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Optimizimi i Kazantores Ndihmëse", me numër të prokurimit: KEKO-20-027-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK), dhe lënda kthehet në **Rivleresim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit te operatorit ekonomik ankues OE "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL" - Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues OE "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL" - Prishtinë,që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik OE "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL" - Prishtinë,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.05.2020 me nr. 310/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull"Optimizimi i Kazantores Ndihmëse", me numër të prokurimit: KEKO-20-027-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK) duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7,56,59,60,62,69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe
- Nenin 41 dhe 42 të RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:01.06.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:10.06.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr. 1, Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: *"Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues"*, dhe si dëshmi dokumentare është

kërkuar: *"Autorizim nga prodhuesi (OEM)"*.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues mendon se Autorizimi i ofruar nga OE ankues "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL, është konform kërkesës në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, sepse askund nuk është kërkuar që Autorizimi të jetë konform specifikimeve të detyrueshme teknike, për më tepër mund ti referohuni arsyes së eliminimit që është shkëputur nga Letra standarde për tenderuesin e eliminuar.
Sipas kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kërkuar që ofertuesi duhet: Të dorëzojë Autorizimin nga prodhuesi (OEM), nuk ka ofruar në ofertë autorizimin e kërkuar nga prodhuesi i pajisjes që është e specifikuar me specifikimin teknik të detyrueshëm, por ka ofruar vetëm autorizime nga prodhues ekuivalent, duke mos prezantuar asnjë autorizim apo marrëveshje teknike me të cilat dëshmohet se prodhuesit ekuivalent kanë me prodhuesin OEM- Bono Energia, Gjithashtu për ta sqaruar sa më mirë arsyen e eliminimit, mendoj se konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, AK-së mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me Autorizimin e ofruar nga OE ankues.
Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe lënda të kthehet në Ri vlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datën 15.06.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datën 15.06.2020 OSHP-në me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, Paneli shqyrtues konform sqarimit të ekspertit shqyrtues konstaton se arsye e eliminimit të OE ankues "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL, sipas AK-se, Autorizimi i ofruar nuk është sipas kërkesave te FDT-së.

Sipas kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ku është kërkuar që ofertuesi duhet: Të dorëzojë Autorizimin nga prodhuesi (OEM), nuk ka ofruar në ofertë autorizimin e kërkuar nga prodhuesi i pajisjes që është e specifikuar me specifikimin teknik të detyrueshëm, por ka ofruar vetëm autorizime nga prodhues ekuivalent, duke mos prezantuar asnjë autorizim apo marrëveshje teknike me të cilat dëshmohet se prodhuesit ekuivalent kanë me prodhuesin OEM- Bono Energia.

Paneli shqyrtues sqaron se për ta sqaruar sa më mirë arsyen e eliminimit, AK konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, të kërkoj sqarime shtesë lidhur me Autorizimin e ofruar nga OE ankues.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a (KEK)

1x1 OE- "KCS TRADE L.L.C DPITS CRAS DOOEL & DPPU DMB PRODUCTION DOOEL"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.